



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“GJEOLOGJI”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**I3-III-16**

Tiranë, Tetor 2016

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

<b>Emërtimi i kualifikimit</b>	<b>Gjeologji</b>			<b>Kodi</b>
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>900-1100 orë</b>	<b>Niveli</b>	<b>III në KSHK, referuar nivelit III të KEK</b>	<b>I3-III-16</b>
<b>Qëllimi:</b>	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional “Gjeologji”, niveli III-të, në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar që lidhen drejtpërdrejt me fushën e Gjeologjisë dhe në shërbimet e ofruara nga kjo fushë, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</p>			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Gjeologji”, të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë përfunduar kualifikimin profesional “Gjeologji-Miniera”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Gjeologji”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe suplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë.</p> <p>Individi ka të drejtë të vazhdojë kualifikimin e mëtejshëm në nivelin IV të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, si teknik/menaxher i mesëm. Me kualifikimin të mëtejshëm ai fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p> <p>Ky kualifikim profesional i jep individit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si punëtor i kualifikuar në sipërmarrje të ndryshme gjeologo-minerare që kryejnë veprimtari për kërkim – zbulim dhe shfrytëzimin e vendburimeve të mineraleve të dobishme dhe të naftës dhe gazit natyral. .</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	Nuk ka			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

## NJOHURI

Individi duhet të dijë të:

### Sfond i përgjithshëm profesional

- Të përkufizojë konceptin e fushës gjeologjike;
- Të tregojë objektin e studimit të gjeologjisë dhe veçoritë e metodave të studimit që përdoren në gjeologji;
- Të përshkruajë veçoritë e proceseve të punës së gjeologjisë;
- Të shpjegojë ç ‘është minerali, si formohet ai dhe cilat janë format e ndodhjes së tyre në natyrë;
- Të tregojë si shprehet përbërja kimike e mineraleve;
- Të listojë vetitë fizike të mineraleve duke përdorur mjete të thjeshta;
- Të klasifikojë mineralet sipas përbërjes kimike të tyre dhe të tregojë përfaqësuesit kryesorë të çdo klase;
- Të shpjegojë ç ‘është shkëmbi;
- Të tregojë si ndahen shkëmbinjtë në bazë të kushteve të formimit dhe si dallohen ata nga njëri tjetri;
- Të përshkruajë, në përgjithësi, rolin dhe rëndësinë e hartografimit gjeologjik;
- Të përshkruajë standardet dhe organizimin e punimeve për kryerjen e hartografimeve gjeologjike shumë disiplinore në shkallë të ndryshme;
- Të shpjegojë metodat dhe mënyrat e hartografimit gjeologjik;
- Të përshkruajë legjendën e një hartë gjeologjike, hidrologjike, tektonike, gjeomorfologjike, të rrezikut gjeologjik dhe gjeomjedisor;
- Të përshkruajë materialet bazë, mjetet dhe organizimin e punimeve paraprake;
- Të përshkruajë përdorimin dhe matjen e elementeve të shtresave gjeologjike me busullën gjeologjike: azimutin e shtrirjes, azimutin e rënies, këndin e rënies;
- Të shpjegojë në përgjithësi metodikën dhe dokumentimin e dukurive gjeologjike në stacionet dhe zhveshjet në terren;
- Të përshkruajë kryerjen e marrjes së provave dhe kampioneve;
- Të shpjegojë metodikën dhe dokumentimin gjeologjik të punimeve minerare dhe shpimeve;
- Të theksojë kriteret e matjeve, të përshkrimit, të marrjes së provave dhe të kampioneve në mineralet dhe shkëmbinjtë, të etiketimit dhe të ambalazhimit;
- Të bëjë përshkrimin e shkurtër të provave dhe të kampioneve si dhe etiketimin, ambalazhimin dhe dorëzimin e tyre në laboratorët përkatës;

### Orientimi dhe matjet gjeologjike

- Të interpretojë elementet e orientimit gjeografik;
- Të përshkruajë proceset e orientimit të punimeve gjeologjike;
- Të interpretojë hartën topografike;
- Të përshkruajë elementët e një planimetrie të punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim - zbulimit;
- Të përshkruajë një skicë të thjeshtë dore për vendosjen e punimeve gjeologjike;

- Të listojë pajisje dhe mjete të thjeshta orientuese dhe matëse (busullën dhe gjysmë rrethin e varur), GPS duke shpjeguar përdorimet e tyre;
- Të shpjegojë dokumentacionin teknik;
- Të përshkruajë, në terren, një punim të thjeshtë gjeologjik, kanal, etj.;
- Të shpjegojë një plan rievimi të thjeshtë gjeologjik me GPS;
- Të përshkruajë përdorimet e programit AUTOCAD në materialet grafike gjeologjike;

**Punimet minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe të shpimit për kërkim – zbulimin e vendburimeve minerale dhe të naftës dhe gazit**

- Të përshkruajë metodat për kërkim-zbulimin e vendburimeve minerale dhe llojet e punimeve për realizimin e tyre.;
- Të përshkruajë llojet e punimeve sipërfaqësore që kryhen në ndihmë të procesit të hartografimit gjeologjik dhe për kërkim – zbulimin e vendburimeve minerale;
- Të përshkruajë llojet e punimeve minerare që kryhen për kërkim – zbulimin e vendburimeve minerale;
- Të përshkruajë mënyrat e hapjes së punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim – zbulimit të vendburimeve minerale;
- Të përshkruajë proceset e rrëzimit të shkëmbit dhe mineralit;
- Të përshkruajë mënyrat e ngarkimit dhe transportit të materialit shkëmbor të rrezuar në punimet minerare të kërkim – zbulimit;
- Të përshkruajë procesin e ajrimit të punimeve minerare të kërkim – zbulimit;
- Të përshkruajë llojet e punimeve të shpimit që kryhen për kërkim – zbulimin e vendburimeve minerale;
- Të përshkruajë pjesët përbërëse kryesore të sondave të shpimit dhe funksionet e tyre;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë procesit të hapjes së punimeve minerare të kërkim – zbulimit.
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik për përdorimin, ruajtjen dhe magazinimin e lëndëve eksplozive;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë procesit të kryerjes së shpimit;
- Të përshkruajë punët kryesore për mirëmbajtjen e punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore;

**Punët me lëndët plasëse**

- Të klasifikojë lëndët plasëse;
- Të listojë lëndët plasëse që përdoren për hapjen e punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim – zbulimit;
- Të përshkruajë mënyrat e transportit të lëndëve plasëse deri në vendin e përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes dhe magazinimit të lëndëve plasëse në vendin ku kryhen punimet sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim – zbulimit;
- Të përshkruajë proceset e punës me lëndë plasëse;
- Të dallojë llojet e ngarkesave me lëndë plasëse;
- Të përshkruajë skemat e plasjes me rrymë elektrike;
- Të përshkruajë skemat e plasjes me fitil zjarr përcjellës;
- Të listojë aparatet për plasjen e ngarkesave me lëndë plasëse;
- Të interpretojë pasaportat e shpimit – plasjes për punimet minerare sipërfaqësore

- dhe nëntokësore të kërkim – zbulimit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik për përdorimin, ruajtjen dhe magazinimin e lëndëve plasëse;

#### **Armatimi i punimeve të kërkim - zbulimit**

- Të përshkruajë veçoritë gjeologjike që kushtëzojnë përdorimin e procesit të armatimit në punimet minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim – zbulimit;
- Të përshkruajë procesin e armatimit të punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim – zbulimit dhe mënyrat e realizimit të tij;
- Të listojë materialet bazë të nevojshme për procesin e armatimit të punimeve minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Të përshkruajë faktorët gjeologjike dhe teknologjike që shkaktojnë ndërprerjet (avaritë) gjatë procesit të shpimit;
- Të shpjegojë metodat e eliminimit të ndërprerjeve të procesit të shpimit dhe mundësimin e vazhdimin normal të tij;
- Të përshkruajë veçoritë gjeologjike dhe teknike që kushtëzojnë përdorimin e tubave të rrethimit të kolonës së shpimit gjatë avancimit të shpimit drejt thellësisë;
- Të përshkruajë materialet bazë të nevojshëm për eliminimin e ndërprerjeve në procesin e shpimit;

#### **Rrëzimi, ngarkimi dhe transporti në miniera**

- Të përshkruajë proceset e rrëzimit të shkëmbit dhe mineralit;
- Të përshkruajë funksionimin dhe mënyrën e përdorimit të makinerive që përdoren për rrëzimit të shkëmbit dhe mineralit;
- Të përshkruajë proceset e ngarkimit të mineralit dhe shkëmbit;
- Të përshkruajë funksionimin dhe mënyrën e përdorimit të makinerive që përdoren për ngarkimin e mineralit në sipërfaqe dhe në nëntokë;
- Të listojë pajisjet që përdoren për transportin e njerëzve dhe materialeve;
- Të përshkruajë mënyrat e transportit në sipërfaqe dhe në minierë;
- Të përshkruajë funksionimin dhe mënyrën e përdorimit të makinerive që përdoren për transportin e mineralit dhe shkëmbit në nëntokë;
- Të përshkruajë procesin e shtrimit të shinave në punimet horizontale;
- Të përshkruajë procesin e shtrimit të shinave në punimet e pjerrëta

#### **Ajrimi në minierë**

- Të përshkruajë procesin e ajrimit të minierës;
- Të listojë aparaturnat matëse për cilësinë e ajrit në minierë;
- Të listojë normat e lejuara të gazeve të dëmshme në minierë;
- Të dallojë sasinë e rrezikshme të pluhurit në ambientin e punës;
- Të përshkruajë dokumentacionin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës;

#### **Elektromekanika në gjeologji dhe në minierë:**

- Të përshkruajë mënyrat e ndriçimit në sheshin e punimeve gjeologjike;
- Të listojë pajisjet që përdoren për ndriçim;
- Të listojë pajisjet që përdoren për prodhimin e ajrit të ngjeshur;
- Të përshkruajë ndërtimin e pompave që përdoren për largimin e ujërave;

- Të përshkruajë proceset dhe pajisjet që përdoren për largimin e ujërave në nëntokë;
- Të përshkruajë kompletin e një sonde shpimi, si dhe funksionin e tij;

#### **Shëndeti, siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit:**

- Të përshkruajë rregullat kryesore të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë rreziqet e ndryshme që mund të shfaqen në punë;
- Të përshkruajë pajisjet mbrojtëse individuale;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse gjatë punës me Sondat gjeologjike;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse nga pajisjet elektrike;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në frontin e shfrytëzimit të mineralit;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në punët me lëndë plasëse;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në punët e rrëzimit të shkëmbit dhe mineralit;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në punët e ngarkimit;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në punët e transportit;
- Të përshkruajë dhënien e ndihmës së parë në minierë;
- Të dallojë rrugët dytësore të kalimit në rast zjarri, apo eksplozioni;
- Të përshkruajë parimet dhe hapat që ndiqen për të mbrojtur dhe rehabilituar mjedisin e dëmtuar nga shfrytëzimi minerar;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Individi duhet të jetë i aftë:

#### **Sfond i përgjithshëm profesional**

- Të zbatojë udhëzuesin (në gjuhë të huajë) e një makinerie të thjeshtë;
- Të vlerësojë hapjen e çarjeve në faqet dhe ballin e punimeve;
- Të përcaktojë fortësinë e shkëmbit me mjete të thjeshta;
- Të mbajë pastër veglat dhe vendin e punës;
- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të kryejë kontrollin teknik të vazhdueshëm të veglave, pajisjeve dhe makinerive që përdor;
- Të respektojë standardet dhe etikën e profesionit;
- Të lexojë dhe interpretojë skica, vizatime dhe dokumentacion teknik;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit;
- Të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës;
- Të kryejë kontrollin vizual të vazhdueshëm të veglave që përdor;
- Të përdorë mjetet dhe materialet e punës;
- Të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës;
- Të përdorë veglat e thjeshta të gjeologut;
- Të përdorë veglat e thjeshta të shpuesit;
- Të përdorë veglat e thjeshta të minatorit dhe armatorit;
- Të përdorë veglat e thjeshta të markshajderit;
- Të zgjidhë probleme të thjeshta që lidhen me ruajtjen e mjedisit.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit, të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit;

## **Gjeologji**

- Të realizojë hartografime të thjeshta të vendit të punës;
- Të kryejë veprime praktike në hapjen e kanaleve dhe të elementeve të tyre;
- Të realizojë dokumentime të thjeshta gjeologjike, minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim-zbulimit dhe të shfrytëzimit të vendburimeve të mineraleve të dobishme;
- Të përgatisë materialet e nevojshme për të kryer dokumentimin gjeologjik;
- Të kryejë dokumentimin gjeologjik të punimeve minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim-zbulimit dhe të shfrytëzimit të vendburimeve të mineraleve të dobishme;
- Të kryejë dokumentimin gjeologjik të kampioneve të mineraleve e të shkëmbinjve, si dhe të shllameve, gjatë procesit të shpimit të puseve;
- Të kryejë marrjen e provave për analiza laboratorike, etiketimin, ambalazhimin dhe dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, sipas metodikave dhe instruksioneve të miratuara;
- Të bëjë matjen e elementeve të shtruarjes së shtresës me anë të busullës gjeologjike;
- Të skicojë dukuritë gjeologjike në stacionet apo zhveshjet gjeologjike në terren;
- Të dokumentojë dukuritë gjeologjike në stacionet apo zhveshjet gjeologjike në terren gjatë procesit të punës;

## **Orientimi dhe matjet në miniera:**

- Të orientohet me hartë topografike në sipërfaqe;
- Të kuptojë dhe përdorë Hartën gjeologjike;
- Të orientohet me planimetri në karrierë;
- Të ndjekë drejtimin e ecjes së shkallëve në karrierë;
- Të masë lartësinë dhe pjerrësinë e shkallëve në karrierë;
- Të ndërtojë një skicë të thjeshtë dore të një shkalle në karrierë;
- Të orientohet me planimetri në nëntokë;
- Të përdorë pajisje dhe mjete të thjeshta orientuese dhe matëse (busullën dhe gjysmë rrethin e varur);
- Të dokumentojë punimet e një nënkati në minierë;
- Të krijojë dosjen e dokumentacionit teknik për një front shfrytëzimi.
- Të ndërtojë një Planimetri të thjeshtë me busull të varur;
- Të ndërtojë një Plan Rilevimi të thjeshtë me GPS;
- Të japë drejtimin e një punimi të thjeshtë horizontal me Busull të Varur;

## **Hapja e punimeve minerare, shfrytëzimi dhe pasurimi i mineralit:**

- Të përcaktojë vendin e stokimit të sterilit ose mineralit;
- Të ndjekë në praktikë punimet minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Të realizojë shpimin e birave me sondë;
- Të përdorë mjetet e thjeshta të punës në punimet minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Të ndajë shkëmbin nga minerali në stoqet e mineralit;
- Të seleksionojë mineralin në transportier;
- Të pastrojë shiritin e transportierit;
- Të kryejë veprime praktike në fabrikat e pasurimit.
- Të kryejë veprime praktike për proceset e largimit të ujërave;

- Të shtrojë tubacione të largimit të ujërave;
- Të pastrojë kanalën e qarkullimit të ujërave;

#### **Punët me lëndët plasëse:**

- Të kryejë veprime praktike ndihmëse të mbushjes së birave dhe plasjes;
- Të realizojë mbushje plasjen e ngarkesave me lëndë plasëse.
- Të realizojë plasjen elektrike të ngarkesave me lëndë plasëse.
- Të realizojë lidhjen në seri, paralel dhe të kombinuar të ngarkesave me lëndë plasëse.
- Të përdorë aparatet për plasjen elektrike të ngarkesave me lëndë plasëse.

#### **Armatimi i punimeve minerare:**

- Të kryejë armatimin e punimeve minerare horizontale;
- Të ndërtojë armatim tip druri për punimet horizontale;
- Të ndërtojë armatim tip druri për punimet e pjerrëta;
- Të kontrollojë punimet për armatura të dëmtuara;
- Të kryejë veprime konkrete në ndërtimin e armaturës së gurit;
- Të bashkojë elementë të armaturave metalike;
- Të kryejë veprime praktike në armatimin e puseve vertikale;

#### **Rrëzimi, ngarkimi dhe transporti në miniera:**

- Të manovrojë me makineri të thjeshta nën mbikëqyrjen e specialistëve;
- Të ngarkojë mineralin ose shkëmbin në vagon;
- Të shkarkojë vagonët në rrotullues;
- Të zgjedhë llojin e veglës, pajisjes, apo makinerisë që duhet të përdoret për transportin e shkëmbit ose mineralit të rrëzuar në karrierë;
- Të përdorë mjetet e makinerisë të thjeshta të transportit në miniera;
- Të përdorë elektrovozin në mbikëqyrje të personelit të kualifikuar;
- Të japë sinjal për uljen dhe ngritjen e kafazit të pusit;
- Të lidhë dhe zgjidhë vagonët me elektrovozin;

#### **Ajrimi në minierë:**

- Të marrë pjesë në vendosjen e ventilatorëve lokalë;
- Të shtrijë tubot e ventilimit në një ballë avancimi;
- Të përdorë aparatet matëse të ajrimit;
- Të marrë kampione ajri dhe pluhuri për analizë;
- Të marrë masat përkatëse dhe të njoftojë personat përgjegjës për praninë e gazit mbi normat e lejuara;

#### **Elektromekanika në Gjeologji dhe minierë:**

- Të kryejë veprime praktike ndihmëse për kontrollin e sistemit elektrik në sipërfaqe;
- Të përdorë pajisjet individuale të ndriçimit;
- Të mbajë në gjendje pune (karikojë) pajisjet individuale të ndriçimit;
- Të ndezë dhe fikë kompresorin e ajrit të ngjeshur;
- Të monitorojë aparatet treguese të presionit në kompresor;
- Të kontrollojë nivelin e vajit të kompresorit;
- Të përdorë pompat për largimin e ujërave nga miniera;



- Të nxjerrë ajrin nga pompat e ujit;
- Të përdorë pajisjet e duhura për funksionimin normal të sondës;

**Shëndeti, siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit:**

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të vendit të punës;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti në vendin e punës;
- Të kryejë veprime praktike për rrethimin e zonave të rrezikshme në karriera;
- Të shfrytëzojë rrugët dytësore të kalimit në rast zjarri, apo eksplozioni;
- Të kryejë punime rehabilituese (mbjellje pemësh) në karriera;

## **KOMPETENCA TË PERGJITHSHME**

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij/saj dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj.
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë efçiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.